



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
SHKOLLA SHQIPTARE E ADMINISTRATËS PUBLIKE
DREJTORIA E ZHVILLIMIT DHE VLERËSIMIT TË CILËSISË

Nr. 330/1 prot.

Tiranë, më 27.04. 2026

NJOFTIM PËR HAPJEN E THIRRJEVE
PËR DHËNIE TRAJNIMI

Në bazë të vendimit nr. 138, datë 12.3.2014 “Për rregullat e organizimit e të funksionimit të Shkollës Shqiptare të Administratës Publike, trajnimin e nëpunësve civilë, si dhe të çdo individ tjetër jashtë shërbimit civil” (I ndryshuar me vkm nr. 349, datë 4.6.2014, vkm nr. 70, datë 27.1.2016, vkm nr. 687, datë 18.11.2021 si dhe vkm nr. 22 dt. 09.01.2025)

Shkolla Shqiptare e Administratës Publike shpall njoftimin për “HAPJEN E THIRRJES PËR DHËNIE TRAJNIMI” si më poshtë vijon :

Thirrje për ekspertë për hartim kurrikule dhe dhënie trajnimi për temën “**Deklarimi i pasurisë dhe konflikti i interesit**”

Detyrat kryesore:

- Trajneri duhet t’u përmbahet të gjitha instruksioneve, kritereve, udhëzimeve të përgjithshme dhe vërejtjeve teknike që do të bëhen nga shkolla.
- ASPA zotëron të drejtën ekskluzive të autorit për kurrikulën e trajnimit ndaj trajneri ndalohej të riprodhojë apo përdorë kurrikulën pa autorizimin e Shkollës Shqiptare të Administratës Publike.
- Trajneri përpara fillimit të trajnimit duhet të paraqesë tek menaxheri i trajnimit dosjen e trajnimit ku përfshihen objektivat, rezultatet e të nxënësve, çështjet teknike që do të trajtojnë me referencë të plotë burimore, matricën didaktike shoqëruar me anekse të detajuara të aktiviteteve që do të zhvillojë gjatë trajnimit.
- Trajnerit i njihet e drejta që brenda kuadrit të objektivave të trajnimit, rezultateve të pritshme të nxënësve dhe kufijve teorik të çështjeve që mbulon trajnimi, të propozojë një matricë didaktike sa më efektive.
- Në çdo rast trajneri duhet të sigurojë që banka e pyetjeve që disponon shkolla është e përshtatshme për kontributin e njohurive të trajtuara në klasë gjatë trajnimit. Nëse konstatohet se banka e pyetjeve nuk është e plotë, trajneri duhet të propozojë pyetje shtesë në përputhje me përmbajtjen e trajnimit të zhvilluar prej tij në klasë.

Kandidatët e interesuar për dhënie trajnimi duhet të përmbushin këto kritere:

Diplomë “Master i Shkencave” ose “Master i Arteve” ose “Master Profesional”, të përfutur në fund të studimeve të ciklit të dytë, me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike apo të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit. të lartë, të paktën 3 vite përvojë pune në fushën përkatëse për të cilën do të ofrojnë trajnimin

Dokumentet e nevojshme për aplikim janë:

- Curriculum vitae (ku të jetë e specifikuar qartë eksperiencia në fushën përkatëse);
- Letër shprehje interesi.
- Kopje e skanuar e librezës së punës

Dorëzimi i dokumentacionit për aplikim mund të bëhet në mënyrë elektronike nëpërmjet dërgimit të tyre në e-mailin zyrtar aspa@aspa.gov.al, në mënyrë fizike pranë protokollit të ASPA si edhe nëpërmjet postës zyrtare në adresën e institucionit, **brenda datës 01.05. 2026**

DREJTOR I KOMANDUAR

Emona Boçe

